

**CATEGORIZATION OF VERB TENSES IN THE TEXTUAL PLANE
ACCORDING TO REXHEP ISMAJLI
KATEGORIZIMI I KOHËVE TË FOLJES NË RRAFSH TEKSTOR SIPAS
REXHEP ISMAJLIT**

Liridona MEHMETI¹

¹ PhD Candidate in Linguistics, Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina“

*Corresponding author e-mail: mehmetiliridona93@gmail.com

Abstract

The purpose of this paper is the study of verb tenses, based on Rexhep Ismajli's treatments with accordance to the treatment in traditional grammar. Throughout this paper we treat time as a verbal category, present the verb tenses, their classification and function. Moreover, we will examine the criteria of verb tense classification, and present the subdivision according to their groups and structure afterwards. Theoretically, the paper is based on two studies conducted by Rexhep Ismajli: "Plurality of the text" (1980) and "Albanian language of the Assembly of Arbën 1706" (1985), in which he treats the verb system, more specifically presents the classification of verb tenses.

Therefore, through this paper we will present the verb tenses beyond the traditional approach. The paper also covers the paradigmatic and syntagmatic relations of the verbal tenses. Altogether, the paper presents the synchrony and diachrony of verb tenses, based on the studies conducted by Rexhep Ismajli. This paper is conducted through qualitative method, given that the whole paper constitutes a theoretical summary of verb tenses according to Rexhep Ismajli. Thus, this paper presents the verb tenses as a grammatical and discourse category, in a plane beyond phrase.

Keywords: *verb, narrative tense, talkative tense, narrating perspective, speaker's position.*

Përmbledhje

Objekt i këtij punimi është studimi i kohëve të foljeve, duke u bazuar në trajtimet e Rexhep Ismajlit përkitazi me trajtimin në gramatikat tradicionale. Gjatë këtij punimi trajtojmë kohën si kategori foljore, paraqesim kohët e foljeve; klasifikimin dhe funksionimin e tyre. Gjithashtu, në këtë punim shqyrtojmë kriteret e klasifikimit të kohëve foljore, pastaj paraqesim nëndarjet sipas grupeve dhe strukturës së tyre. Teorikisht, punimi është i mbështetur në dy studimet e Rexhep Ismajlit; "Shumësia e tekstit" (1980) dhe "Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit 1706" (1985), në të cilat trajton sistemin foljor, më saktësisht paraqet kategorizimin e kohëve të foljes.

Pra, nëpërmjet këtij punimi kemi si qëllim të paraqesim kohët e foljeve përtej qasjes tradicionale. Punimi përfshin edhe trajtimin e raporteve paradigmatiche dhe raporteve sintagmatike të kohëve të foljes. Si tërësi punimi paraqet sinkroninë dhe diakroninë e kohëve foljore, duke u bazuar në studimet e Rexhep Ismajlit. Punimi është realizuar me anë të metodës cilësore (kualitative), pasi i tërë punimi përbën një përmbledhje teorike për kohët e foljes sipas Rexhep Ismajlit. Pra, në këtë punim paraqesim kohët foljore, si kategori gramatikore dhe ligjërimore, në një rrafsh përtej frazës.

Fjalët kyçe: *folje, kohë rrëfimore, kohë përfolëse, perspektivë folëse, pozicioni i folësit.*

1. Hyrje

Në studimet e gramatologjisë tradicionale kohët e foljeve janë studiuar kryesisht në rrafsh të fjalisë. Ndërkaq, studimi i kohëve të foljeve në kuadër të gramatikës së tekstit në gjuhën shqipe ka nisur gjatë viteve të tetëdhjeta me studimet e Rexhep Ismajlit, duke vazhduar me studimet e Shezai Rrokajt, Tafil Kelmendit, Linditë Tahirit, Arbër Çelikut, Klodeta Dibrës, Nonda Varfit, Hasan Mujajt, Linditë Sejdiut - Rugovës e Bardh Rugovës.

Në Gramatikën e Gjuhës Shqipe (2002:274) paraqitet se gjuha shqipe ka një pasuri sa i përket formave gramatikore foljore, nëpërmjet të cilave shprehen jo vetëm kuptime kohore, por edhe ngjyrimet aspektore të ndryshme. Koha e shkuar e mënyrës dëftore, e cila ka pesë nëndarje kryesore: të pakryerën, të kryerën e thjeshtë, të kryerën, më së të kryerën dhe të kryerën e tejshkuar. Disa nga këto (e kryera me më së të kryerën dhe të kryerën e tejshkuar) dallohen për nga ngjyrimet kohore. Kurse, e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera kanë më fort karakter aspektor; e pakryera zakonisht e paraqet veprimin në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës, ndërsa e kryera tregon një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimin.

R. Memushaj (2014:224,225) vlerëson se kategoria gramatikore e kohës është një ndër kategoritë më tipike të foljes, madje edhe kategoria më e rëndësishme e saj. Këtë konstatim e mbështeti, duke marrë për bazë pikëpamjet e Aristotelit. Sipas tij, folja dallon nga emri: folja tregon kohë, ndërsa emri është pa kohë. Koha si kategori gramatikore ka lidhje me kohën si kategori objektive, që është një nga përmasat e ekzistencës së materies. Por, megjithatë, këto dy kategori nuk janë identike, pasi kategoria gramatikore e kohës është e varur prej kohës objektive dhe veç kësaj ka karakter subjektiv. Pra, kategorinë gramatikore të kohës e përbën pikërisht çasti i të folurit, me të cilin duhet kuptuar momenti kur folësi kumton diçka me gojë ose me shkrim.

J. Lyons-i (2001:284), kategorinë e kohës e paraqet të ndërlidhur me marrëdhëniet kohore, derisa gjejnë shprehje sistematike në kundërvëniet gramatikore, të cilat i ka njohur edhe gramatika tradicionale në gjuhë të ndryshme. Tri kundërvëniet të tilla janë: *e shkuaara*, *e tashmja* dhe *e ardhmja*. Si tipar themelor i kategorisë së kohës është vendosja e marrëdhënieve midis kohës së veprimit, të ngjarjes ose të gjendjes, të gjërave, të cilave u referohet fjalia dhe kohës së shprehjes që i përket çastit të ligjërimin.

Ndërkaq, prej F. Sosyrit e këndeje në gjuhësi dallohen dy lloje raportesh midis njësive të ndryshme të gjuhës: në një anë i kemi raportet midis njësive të ndryshme në kujtesë, por që gjatë aktualizimit nuk mund të dalin përnjëherë në ligjëratë; raportet në mungesë të elementeve që krijojnë këto raporte, e në anën tjetër raportet midis njësive të realizuara në ligjëratë, pra raportet e njësive të pranishme. Të parat quhen raporte paradigmatiske, ndërsa të dytat raporte sintagmatike (Ismajli, 1980:91).

Sipas Ismajlit (1980:91,94), foljet dhe kohët e tyre mund të aktualizohen në ligjëratë, bashkë me njësi të tjera, pra në bashkekzistencë sintagmatike me klasët e tjera. Për këtë arsye çdo studim i kohëve të foljeve duhet të nisët nga tërësia e tillë, pra nga kodi dhe nga ligjëratat. Për nga informacioni kohët e foljeve dallojnë midis tyre, jo vetëm për sa i përket raportit ndaj kohës fizike. Që nga antika ndarja e kohëve që bërë tërësisht: *e shkuar/e tashme/ e ardhshme*.

Sipas tij, ky konceptim presupozon një barazim të çështjeve dhe të rrjedhave gjuhësore me çështjet dhe rrjedhat mendore, filozofike. Nëse midis kohës; *kohës* dhe *kohës së foljeve* vëmë shenja barazimi, atëherë do të duhej të kishim gjithmonë një kohë të tashme në të tashmen, një të shkuar në të shkuarën. Mirëpo, në gjuhë nuk ndodh kështu; distribucioni i kohëve të foljeve në tekst nuk është larg më i ndryshëm, sepse këto kohë funksionojnë si shenja, si të gjitha shenjat e tjera të gjuhës.

Kohë të ndryshme të foljeve të një gjuhe, të përkufizuara tradicionalisht në bazë të kronologjisë, të aktualizuara në tekst mund të kenë funksione të ndryshme edhe kronologjike, po edhe të tjera, sidomos funksione që lidhen me tërësinë e tekstit jashtë fjalisë. Sipas një ndarjeje gati të përgjithshme tradicionale, e cila ka të bëjë vetëm me çështjet e nivelit të frazës, kohët e foljeve të një gjuhe indoevropiane do të mund të gruponim në tri grupe të mëdha: *kohë të shkuara*, *kohë të tashme* dhe *kohë të ardhshme*. Pra, objekt i këtij punimi është studimi i kohëve të foljeve, bazuar në trajtimet e Rexhep Ismajlit përkitazi me trajtimin e tyre në gramatikat tradicionale. Gjatë këtij punimi trajtojmë kohën si kategori foljore, si dhe paraqesim kohët e foljeve sipas klasifikimit dhe funksionimit të tyre.

2. Kategorizimi i kohëve të foljes sipas Rexhep Ismajlit

R. Ismajli (1980:95) ndarjen e përgjithshme të kohëve foljore në tri grupe (e shkuar, e tashme, e ardhme) sipas gramatikave tradicionale, e vlerëson si çështje të diskutueshme, duke i pasur parasysh variacionet që krijojnë monemat e tilla, si: aspekti⁸², mënyra dhe diateza, të cilat nuk janë njësoj dhe as që të gjitha të pranishme në të gjitha gjuhët. Lidhur me këtë, sipas studiuesve L. Rugova dhe B. Rugova (2015:169), në rrafshin kuptimor ka ndërthurje mes tri nocioneve: kohë, aspekt dhe modalitet.⁸³ Gjithashtu, në një trajtim në gjuhësinë bashkëkohore, J. Lyons-i (2001:284), paraqet gërshetim mes kohës, mënyrës dhe aspektit të foljeve.

Sipas R. Ismajlit, koha, aspekti dhe modaliteti janë nocione që ndërthuren me njëra-tjetrën dhe në shqipen është vështirë të bëhet ndarje e mprehtë midis tyre, edhe më shumë kur kemi parasysh se në shqipen këto nocione shprehen me mbaresa dhe elemente të tjera të fleksionit e që ua mveshin këtyre kategorive atributin gramatikor. Për çështjen e funksionit të foljeve në kuadër të tekstit, Ismajli thekson faktin se gjuhësia i ka hulumtuar, kur me sukses e kur pa sukses raportet paradigmatiske, duke i lënë anash raportet sintagmatike. Ai duke analizuar tekstet letrare bën një klasifikim të foljeve, që del nga niveli i përtëjfracës. Ky klasifikim nuk shquan vetëm mospërputhjen e konceptit filozofik dhe gjuhësor të kohës, por sidomos nxjerr në pah shumëfishësinë e morfemave rrënjore dhe foljore, si: *koha*, *aspekti*, *mënyra* dhe *diateza*.

2.1. Kriteret për klasifikimin e kohëve të foljes sipas Rexhep Ismajlit

Për ndarjen e kohëve të foljeve R. Ismajli (1980:96,97) merr për bazë tri kriteret: *qëndrimin e folësit*, *perspektivën folëse* dhe *relievizimin e tekstit*. Ai trajton kohët e foljeve, duke u mbështetur në klasifikimet e studiuesve botërorë, si: Dykros, Todorovit, Emil Benvenistes, Claus Hegerit, Weinrich Haraldit, të cilët trajtojnë kohët e foljeve edhe në rrafshin tekstor. Sipas kriterit të parë - *qëndrimin folës*, kohët e foljeve ndahen në *komentative* (përfolëse) dhe *kohë narrative* (rrëfimore). Në kohët përfolëse bëjnë pjesë: *etashmja* (prezenti), *perfekti* (e kryera) dhe *futuri* (e ardhmja).

Mbështetur në studimet e Rexhep Ismajlit, studiuesi B. Rugova (2009:189), paraqet se në gjuhën shqipe, në kohë komentative (përfolëse) do të mund të bënin pjesë: koha e tashme, koha e kryer, koha më se e kryer dhe koha e ardhme e dëftores. Pra, si kohë përfolëse ai shton edhe *më së të kryerën*. Ndërsa, në kohë rrëfimore bëjnë pjesë: *e pakryera* (imperfekti), *aoristi* (e kryera), *e kryera e tejshkuar* (perfekti II) dhe *e tashmja e lidhore* (prezenti i lidhore).

⁸² Nocioni aspekt përdoret për të shenjuar mënyrën e paraqitjes së zhvillimit të veprimt të emërtuar nga folja. Kategoria gramatikore e aspektit nuk është zhvilluar në sistemin foljor të shqipes, i cili karakterizohet nga kategoria gramatikore e kohës.

⁸³ Me nocionin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimin të folësit ndaj asaj që e kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv.

Nga këto grupëzime përjashtohen format e ashtuquajtura gjysmë të mbaruara ose të pambaruara, si: *paskajorja, pjesorja, përcjellorja*;⁸⁴ Sipas kriterit të dytë – *perspectives folëse*, dallohen kohët e së shkuarës, të së tashmes dhe të së ardhmes; Sipas kriterit të tretë - *relievizimit të tekstit*, kohët dallohen në kohë që mbajnë planin e parë të rrëfimit dhe në kohë që japin prapavijën. Kohë e planit të parë është *koha e kryer*, ndërsa kohë të prapavijës janë *më se e kryera* dhe *e kryera e tejshkuar*. Ndarja e kohëve foljore sipas kriterit të parë është e vlefshme edhe për gjuhën shqipe, pasi dominojnë këto kohë në tekstet rrëfimore dhe përfolëse, të cilat për dallim nga të parat janë më të zhveshura nga subjektivizmi dhe distancimi i folësit, pra më neutrale. Ndërkaq, si kohë neutrale janë: e kryera për *enoncimin përfolës*, ndërsa e kryera e thjeshtë dhe e pakryera për *enoncimin rrëfimor*.

R. Ismajli (1985:217) vlerëson se kohët e komentit dhe të rrëfimit nuk mund ta kapin tërësinë e sistemit të foljeve të përdorura në tekstin e *Kuvendit të Arbënit*,⁸⁵ për shkak se lënë jashtë mënyrat, aspektin dhe diatezën. Ndërsa, kohët e së shkuarës, të së tashmes dhe të së ardhmes, të cilat kanë për detyrë ta mbajnë planin e rrëfimit dhe të na japin prapavijën, bashkë me planin e rrëfimit. Pra, kohët e foljeve funksionojnë edhe si rrjedhë veprimi në një fjali, por edhe si bartëse të informacioneve në kuadër të tekstit si tërësi gjuhësore. Nga kjo mund të themi se kohët e foljeve kanë funksion të dyfishtë.

3. Përfundimi

Mund të pohojmë se kohët e foljeve në gjuhën shqipe janë trajtuar kryesisht nga aspekti i ndërtimit (strukturës), pothuajse në të gjitha gramatikat tradicionale, kurse në studimet e Rexhep Ismajlit marrin një këndvështrim tjetër, duke u zgjeruar funksioni i tyre përtej frazës. Ai, duke u mbështetur edhe në studimet e tjera bën ndarjen në kohë rrëfimi, komenti, deiktike, historike, të planit të parë dhe të prapavijës. Derisa në gramatikat tradicionale kohët e foljes trajtohen si kategori gramatikore të foljes, të cilat tregojnë çastin e kryerjes apo pritshmërisë së një veprimi dhe si qendra sintaksore të fjalisë, në studimet e R. Ismajlit kohët e foljeve trajtohen si kategori tekstore dhe aspektore, duke marrë si tërësi funksionimin e foljeve në kuadër të teksteve.

Si përfundim mund të themi se Rexhep Ismajli trajton kohët e foljeve, jo vetëm në aspektin gramatikor, por edhe në ligjërimin kontekstual. Ai trajton kohët e foljeve, duke marrë për bazë tekstin si njësi ligjërimore, po ashtu në bazë të kriterëve, si: qëndrimin folës, perspektivës folëse (këndvështrimin) dhe relievizimit të tekstit. Pra, kohët e foljeve sipas Ismajlit vështrohen në rrafshin ligjërimor (diskursiv), tekstor dhe aspektor.

Referencat

- [1]. ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- [2]. Rugova, Bardh. (2009). *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: KOHA.
- [3]. Rugova, Bardh dhe Rugova-Sejdiu, Linditë. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat.
- [4]. Lyons, John. (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*. E. Likaj (përkth.). Tiranë: Dituria.
- [5]. Ismajli, Rexhep. (1980). *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja.
- [6]. Ismajli, Rexhep. (1985). *Gjuha shqipe e "Kuvendit të Arbënit" (1706)*. Prishtinë: Rilindja.
- [7]. Memushaj, Rami. (2014). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë: Toena.

⁸⁴ Këto forma tradicionalisht quhen forma të pashtjelluara foljore.

⁸⁵ *Gjuha e Kuvendit të Arbënit (1706)-hulumtime grafike-fonologjike*, teza e doktoratës së R. Ismajlit, të cilën e mbrojti në vitin 1882, në Universitetin e Prishtinës.